



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 604 Akti

Nr. 377 Vendimi
Tiranë, më 27.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|-----------------------|-----------|
| Firdes Shuli | Kryesuese |
| Lulzim Hamitaj | Relator |
| Roland Ilia | Anëtar |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 23.4.2021, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim, në seancën dëgjimore publike, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Sokol Pina, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, aktualisht i komanduar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Pina, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë¹, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 23.4.2021, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Z. Sokol Pina ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); si dhe pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD).
- ii. Pika 4 e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*. Në këto kushte, dhe duke konsideruar kandidimin e subjektit për emërim në gjykatën e apelit, ka filluar me përparësi procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Pina.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, për shkak të përparësisë së këtij rivlerësimi, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur një short të veçantë në datën 2.12.2020, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Pina, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Lulzim Hamitaj dhe Roland Ilia.
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi dhe studioi të tria raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 15.12.2020, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të po këtij ligji; dhe (ii) me mirëkuptim, të caktohej kryesuese e trupit gjykues komisionere Firdes Shuli. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.
- v. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Sokol Pina, me vendimin nr. 2, datë 12.4.2021, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
- vi. Në datën 13.4.2021 Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar

¹ Aktualisht i komanduar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

të kundërtën – për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.

- vii. Ndonëse nuk u njoh me dosjen përkatëse, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht, përpara afatit të caktuar nga Komisioni.
- viii. Në datën 20.4.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, të caktuar në datën 23.4.2021, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Pina, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Sokol Pina ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 23.4.2021 u mbyll, për të rifilluar më 27.4.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ); (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht; si dhe (x) përmbajtjen e dy opinionëve me shkrim të paraqitura nga ONM-ja.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-JA

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

1. Apartament në përdorim, me vendndodhje në Sarandë

1. Ky apartament është deklaruar nga subjekti si adresë banimi për herë të parë në DIPP-në e vitit 2016. Gjithashtu, në deklaratën *Vetting* është deklaruar si send në përdorim, përkundrejt qirasë mujore prej 10,000 lekësh – fillimisht në bazë të një marrëveshjeje verbale dhe më pas të formalizuar me një kontratë qiraje me nr. ***, të lidhur në datën 18.10.2016. Në këtë kontratë palët kanë deklaruar se marrëveshja verbale ka filluar në janar të vitit 2016.
2. Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 17.12.2020, Ministria e Drejtësisë, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira, Regjistri Noterial, ka konfirmuar ekzistencën e regjistrimit të kontratës së qirasë nr. ***, datë 18.10.2016, lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe znj. L. B.².
3. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar ASHK-së Sarandë të dhënat e pronësisë së apartamentit në përdorim të subjektit, me anë të kërkesës nr. *** prot., datë 9.12.2020, e cila në përgjigjen e saj me shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2020, ka bërë me dije se pasuria e sipërpërmendur është në pronësi të bashkëpronarëve S. B., L. B., S. B. dhe I. B.. Kjo pasuri

² Gjithashtu, janë evidentuar dy veprime noteriale, përkatësisht kontrata e huas nr. ***, datë 14.8.2019, dhe lëshim dëshmi trashëgimie nr. ***, datë 6.6.2019, të cilat janë jashtë periudhës së rivlerësimit.

është përfituar me anë të kontratës për privatizimin e banesës (formulari nr. 3), datë 29.5.1993, kundrejt çmimit 11,475 lekë³.

4. Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit me qiradhënësit, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke i kërkuar informacion nëse për këta shtetas ka pasur çështje të gjykuara. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2020, ka bërë me dije se për shtetasit L. B., S. B., S. B. dhe I. B. nuk është dhënë ndonjë vendim apo nuk ka rezultuar ndonjë çështje në proces shqyrtimi/gjykimi, ku palët ndërgjyqëse të kenë qenë/jenë shtetasit në fjalë.
5. Gjithashtu, në kuadër të kryerjes së një hetimi gjithëpërfshirës, nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-të në rrethe⁴ ka rezultuar se nuk figurojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Pina. Sikurse është konfirmuar edhe nga verifikimet e kryera *online* nga Komisioni në Sistemin Multifunksional ZVRPP – për sa kohë nuk ka rezultuar ndonjë pasuri e paluajtshme e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Pina.
6. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin e përshkruar si vijon:
 - i. Kontratë qiraje pa afat të përcaktuar, me nr. ***, datë 18.10.2016, e lidhur midis qiradhënëses L. B.⁵ dhe qiramarrësit Sokol Pina, për marrjen me qira nga ana e subjektit të apartamentit me sip. 88 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në z.k. ***, Sarandë, kundrejt qirasë mujore prej 10,000 lekësh.
 - ii. Certifikatë për vërtetimin e pronësisë të pasurisë së llojit “apartament” me të dhënat e mësipërme kadastrale, të regjistruar në emër të bashkëpronarëve S. B., L. B., S. B. dhe I. B..
 - iii. Kontratë për privatizimin e banesës (formulari nr. ***) e datës 29.5.1993, lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komonale Banesa dhe qiramarrësit S. B..
 - iv. UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2020, ka bërë me dije se në emër të

³ ASHK-ja Sarandë ka vënë në dispozicion gjithashtu praktikat e pasurive të tjera të regjistruara në emër të qiradhënësit S. B., nga ku ka rezultuar se ky i fundit ka blerë me anë të kontratës nr. ***, datë 3.9.1992, nga shitësi Komiteti Ekzekutiv Sarandë, një truall me sip. 182 m², bazuar në VKM-në Nr. 305, datë 20.7.1992. Me vendimin nr. ***, datë 29.7.2003, të KRRT-së është miratuar destinacioni i sheshit të ndërtimit me sip. 310 m², në emër të shtetasit S. B., për një objekt studio mjekësore dhe banesë. Më pas, në datën 24.5.2004, me anë të kontratës nr. ***, shtetasi S. B. ka blerë nga shitësi Bashkia Sarandë truallin me sip. 310 m², mbi të cilin është ndërtuar objekti i sipërcituar. Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore, në përfundim, në emër të shtetasit S. B. rezulton e regjistruar pasuria në total me sip. 492 m² truall dhe ndërtesë 3-katëshe, me sip. 210 m² çdo kat, e ndodhur në Lagjen nr. ***, Sarandë.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2021, ASHK-ja Lushnjë ka informuar se në emër të babait të subjektit të rivlerësimit z. D. P., kanë rezultuar gjithsej 6 pasuri të paluajtshme, përkatësisht: (i) pasuri e llojit “apartament”, me sip. 71 m², e privatizuar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 19.7.1996, nga Komisioni i Privatizimit të Rrethit Lushnjë dhe shitur në vitin 1997; (ii) pasuri e llojit “arë”, me sip. 720 m², ndodhur në D., Lushnjë, blerë me kontratën nr. ***, datë 23.7.2002, dhe shitur në vitin 2006; (iii) pasuri e llojit “arë”, me sip. 450 m², ndodhur në D., Lushnjë, blerë me kontratën nr. ***, datë 24.7.2002, dhe shitur në vitin 2006; (iv) pasuri e llojit “arë”, me sip. 250 m², ndodhur në D., Lushnjë, blerë me kontratën nr. ***, datë 23.8.2002, në bashkëpronësi me shtetasit A. N., Sh. A. dhe H. Sh.; (v) pasuri e llojit “arë”, me sip. 1,270 m², ndodhur në L., Lushnjë, përfituar një pjesë me anë të trashëgimisë ligjore, sipas vendimit nr. *** akti, datë 1.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe pjesa tjetër blerë bashkëpronarëve të tjerë me kontratën nr. ***, datë 3.12.2004; (vi) pasuri të llojit “arë”, me sip. 4,395 m², “truall”, me sip. 200 m² dhe “ndërtesë”, me sip. 63 m², të ndodhura në L., Lushnjë, përfituar një pjesë me anë të trashëgimisë ligjore, sipas vendimit nr. *** akti, datë 1.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe pjesa tjetër blerë bashkëpronarëve të tjerë me kontratën nr. ***, datë 3.12.2004.

⁵ Shtetasja L. B. ka nënshkruar kontratën e qirasë me subjektin e rivlerësimit dhe nga shqyrtimi i saj nuk duket të këtë marrë edhe dakordësinë e bashkëpronarëve të tjerë dhe nuk rezulton të jetë bashkëlidhur kontratës, ndonjë prokurë.

subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për kontrata për shërbime të Ujësjetllës - Kanalizime Tiranë.

- v. FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 30.12.2020, ka bërë me dije se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë rezultuar të jenë abonentë dhe të kenë kontrata të furnizimit me energji elektrike⁶.

1.1. Lidhur me vendbanimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite

7. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 21.12.2020, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se prej momentit që ka marrë detyrën dhe deri në janar të vitit 2016⁷ ka banuar në adresat e mëposhtme:
- a. Apartament me qira, me adresë: rr. "D. e F.", shk. 1, k. 2, ap. 3, Tiranë, me anë të marrëveshjes verbale të qirasë, e cila është bërë fillimisht nga vëllai i tij në vitin 2010 dhe qiraja mujore paguhej *cash*⁸ së bashku me vëllain. Ky apartament ka qenë në pronësi të shtetas L. P., së bashku me bashkëshortin.
 - b. Apartament me qira, me adresë: Lagjja nr. ***, rr. "M. H.", p. 109, K., Sarandë, në pronësi të shoqërisë "****" sh.p.k.⁹ Për të provuar sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.12.2020¹⁰, të lëshuar nga shoqëria "****" sh.p.k., e përfaqësuar nga administratori F. I., sipas së cilës për periudhën tetor – dhjetor 2015 subjekti ka banuar në këtë apartament kundrejt qirasë mujore prej 15,000 lekësh, shumë kjo që i dorëzohej njërit prej ortakëve, z. K. I.
8. Lidhur me apartamentin e përmendur në pikën "a", në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se ka banuar në këtë apartament prej dhjetorit të vitit 2010 deri në fund të shtatorit të vitit 2015. Po ashtu, ka bërë me dije se qiraja ka qenë 20,000 lekë/muaj dhe nga viti 2011 e deri në fund¹¹ subjekti ka paguar gjysmën e shpenzimeve, në masën 10,000 lekë.
9. Lidhur me apartamentin e përmendur në pikën "b", nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor të apartamentit në pronësi të shoqërisë "****" sh.p.k., në përgjigje të të cilit ka bërë me dije se nuk e disponon dhe nuk ka mundësi ta sigurojë atë, pa dhënë shpjegime të mëtejshme.
10. Për sa i përket marrëdhënieve të mundshme familjare/shoqërore apo të çfarëdolloji, subjekti ka pohuar se ka njohje me shtetasin K. I. (ortak i shoqërisë në fjalë) vetëm për shkak të

⁶ FSHU-ja ka bërë me dije se në emër të shtetasit me gjeneralitetet Dh. P. (pa atësi) figuron një kontratë furnizimi me nr. ***, në instancën Lushnjë. Kjo kontratë ka të regjistruar adresën "K. Q.", datë vul 17 11 10" të lëshuar në datën 7.6.2005.

⁷ Momenti kur ka filluar të banojë në apartamentin e marrë me qira nga bashkëpronarët B..

⁸ Referuar përgjigjes së subjektit në pyetësorin nr. 1, pagesa e qirasë nuk i bëhej pronarëve të apartamentit, pasi ata nuk jetonin në Shqipëri dhe nuk kishin kontakte me ta, por i paguhej një të afërmi që merrej me administrimin e pasurisë me emrin "A.", për mbiemrin e të cilit nuk ka informacion dhe është në pamundësi që të sigurojë dokumentacion provues.

⁹ Nga kërkimi në faqen zyrtare të QKB-së, www.qkb.gov.al, shoqëria "****" sh.p.k. është regjistruar në datën 1.8.2003, me nr. NIPT ***, me administrator F. I. Ortakët e shoqërisë janë D. I., F. I. dhe K. I..

¹⁰ Shoqëria rezultoi ta ketë pezulluar aktivitetin në datën 3.6.2020.

¹¹ Subjekti ka bërë me dije se në muajt e fundit të qëndrimit, pas largimit të vëllait të tij, subjekti ka përballuar të gjithë shumën prej 20,000 lekësh i vetëm. Duke qenë se subjekti nuk ka bërë specifikimet përkatëse të periudhës së largimit të vëllait nga kjo banesë, Komisioni ka marrë në konsideratë në analizën financiare përballimin e të gjitha shpenzimeve të qirasë së vitit 2015 (periudhë 9-mujore) nga ana e subjektit.

marrëdhënies së qirasë, ndërsa me dy ortakët e tjerë, z. F. I. dhe z. D. I., nuk ka asnjë lloj njohjeje. Subjekti ka deklaruar se me asnjërin prej tyre nuk ka ndonjë konflikt interesi.

11. Lidhur me adresën e deklaruar në gjendjen civile (përshkruar edhe në deklaratën *Vetting*) “Njësia Administrative nr. 171, lagjja ‘K. Q.’ ***, Lushnjë”, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti ka bërë me dije se bëhet fjalë për adresën e prindërve të tij, të cilën nuk e kanë të regjistruar në pronësi. Godina ka qenë ndërtuar përpara viteve 1990, në të cilën ka qenë ish-Komanda e Forcave Vullnetare të Rrethit Lushnjë dhe prindërit e tij, së bashku me familje të tjera, e kanë përshtatur për banesë në të cilën vazhdojnë të jetojnë edhe aktualisht.
12. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni – duke mbajtur në konsideratë edhe opinionin e datës 2.2.2021, të përcjellë nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, lidhur me sa i përket vendbanimeve të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Pina – ka përfshirë në analizën financiare shpenzimet e qirasë për periudhën 2013¹² – 2015. Ndonëse ato nuk janë të provuara me një dokumentacion ligjor, trupi gjykues ka vlerësuar kështu, për sa kohë nga njëra anë nuk mund të injorohet (pa u përllogaritur), dhe nga ana tjetër nuk mund të arrihet një provë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë që të mundësojë konstatimin e ekzistencës së një shpenzimi të ndryshëm nga ai që pretendon subjekti.
13. Gjithashtu, nga hulumtimet e kryera nga Komisioni, adresa e deklaruar prej subjektit ka rezultuar se ndodhet në zonën 7/4 të Tiranës. Pavarësisht faktit se në atë periudhë nuk ekzistonte një çmim reference mbi qiratë e apartamenteve të banimit, referuar VKM-së Nr. 469, datë 3.6.2015, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, çmimi i qirasë nuk duhet të jetë më i ulët se 0.3 % e çmimit të shitjes së pasurisë. Si pasojë e sa më sipër, nëse këto të dhëna do të projektoheshin/reflekttoheshin si një instrument matës/vlerësues mbi rrethanën konkrete, do të rezultonte se çmimi i qirasë prej 20,000 lekësh/muaj – duke e referuar sipas deklaramit të subjektit, në mungesë të një burimi të besueshëm alternativ, bazuar në çmimin e referencës së shitjes në zonën përkatëse – do t’i përkiste një apartamenti me sipërfaqe rreth 100 m², e cila duket brenda kufijve të tregut, dhe jo jashtë logjikës ekonomike, për ta konsideruar jo të mundshëm/besueshëm. Për rrjedhojë, nuk është evidentuar ndonjë arsye për përjashtimin nga përllogaritja në analizën financiare, pra, për mosmarrjen në konsideratë të shpenzimeve të qirasë të deklaruara nga subjekti – për më tepër që në periudhën në fjalë nuk ka pasur një përcaktim të çmimit të tregut të qiradhënies nga strukturat përkatëse shtetërore.
14. Po ashtu, Komisioni i ka kërkuar ASHK-së Sarandë, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 1.2.2021, informacion lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament”, të ndodhur në adresën: Lagjja nr. ***, rr. “M. H.”, p. ***, K., Sarandë, të regjistruar në pronësi të shoqërisë “***” sh.p.k.
15. Lidhur me pasuritë e paluajtshme të shoqërisë në fjalë, Komisioni iu drejtua ASHK-së Sarandë, e cila, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 1.3.2021, vuri në dispozicion kartelat e 10 pasurive të paluajtshme të ndodhura në Lagjen nr. ***, Sarandë dhe të regjistruara në

¹² Nga fillimi i detyrës së subjektit të rivlerësimit.

emër të shoqërisë “****” sh.p.k.¹³.

16. Nga përshkrimi i apartamentit të bërë në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit (në deklaratën noteriale), si dhe nga të dhënat kadastrale të apartamenteve në dokumentacionin e ardhur nga ASHK-ja Sarandë, nuk mund të identifikohet apartamenti i marrë me qira nga subjekti i rivlerësimit, pasi nuk ka ndonjë element të përbashkët të të dhënave.
17. Gjithashtu, është konstatuar se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë vendbanimi: Lagjja nr. ***, rr. “L. T.”, mbrapa shkollës “H. T.”, shk. ***, k. ***, ap.***, Sarandë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se bëhet fjalë për të njëjtin apartament me adresë: Lagjja nr. ***, rr. “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Bashkia Sarandë, por fillimisht në plotësimin e DIPP-së së vitit 2015 ka deklaruar adresën sipas dijenisë të tij (për sa kohë marrëveshja e qirasë ishte thjesht verbale), dhe më pas ka bërë deklarinimin e saktë sipas adresës në certifikatën e pronësisë.
18. Përgjatë hetimit administrativ, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë të dhëna të sakta dhe specifike kadastrale të pasurisë së paluajtshme të ndodhur në Njësinë Administrative nr. 171, lagjja “K. Q.” ***, Lushnjë, të përdorur nga prindërit, si dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës mbi pronësinë aktuale të saj. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se nuk ka dijeni nëse kjo godinë është e regjistruar, cili është organi shtetëror pronar apo administrator i saj dhe se nuk mund të sigurojë të dhëna konkrete kadastrale të godinës. Subjekti ka shtuar se godina është përshtatur në mënyrë informale për banim dhe se nuk është zhvilluar ndonjë proces gjyqësor apo ndonjë procedurë administrative për privatizimin, zotërimin, gëzimin apo lirimin e pasurisë në fjalë.
19. Në këto kushte, me aq të dhëna sa disponon Komisioni, në mungesë të të dhënave kadastrale të pasurisë apo të organit shtetëror i cili mund të administrojë pasurinë në fjalë, rezulton e vështirë kryerja e një identifikimi/verifikimi të mëtejshëm. Megjithatë, Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë informacion lidhur me çështje të mundshme gjyqësore me objekt “çfarëdo të drejte reale mbi pasuri të paluajtshme”, me palë ndërgjyqëse prindërit e subjektit të rivlerësimit, Dh. dhe E. Pina. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2021, ka bërë me dije se në emër të shtetasve Dh. P. dhe E. P. nuk ekziston ndonjë vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me objekt “të drejtat reale mbi ndonjë pronësi” dhe nuk ka çështje të regjistruara me palë ndërgjyqëse këta persona.
20. Trupi gjykues, nisur nga sa më sipër, dhe në analizë të materialit të administruar, ka konkluduar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me vendbanimet e subjektit të

¹³ ASHK-ja Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 1.3.2021, ka vënë në dispozicion kartelat e pasurive të paluajtshme të llojit “apartament”, me z. k. ***, të ndodhur në Lagjen nr. ***, Sarandë, me nr. pasurie, si vijon: nr. ***, apartamenti nr. ***, me sip. 55.08 m²; nr. pasurie ***, apartamenti nr. ***, me sip. 55.08 m²; nr. pasurie ***, apartamenti nr. ***, me sip. 94.96 m²; nr. pasurie ***, apartamenti nr. ***, me sip. 55.08 m²; nr. ***, apartamenti nr. ***, me sip. 105.45 m²; nr. pasurie ***, apartamenti nr. ***, me sip. 105.45 m²; me nr. pasurie ***, apartamenti nr. ***, me sip. 105.45 m²; nr. pasurie ***, apartamenti nr. ***, me sip. 93.96 m²; nr. pasurie ***, me sip. 93.96 m²; nr. pasurie ***, apartamenti nr. ***, me sip. 94.96 m²; nr. pasurie ***, me sip. 55.08 m², në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k.

rivlerësimit dhe mosdeklarimi në DIPP-në të përdorimit të pasurive të paluajshme në pronësi të personave të tretë, ndonëse përbën një pasaktësi në deklaratat periodike vjetore, në vetvete kjo rrethanë nuk përbën një shkak për të pasjellë pasoja për subjektin e rivlerësimit.

2. Automjet tip “Ford Focus” e vitit 2003, me targa ***

21. Automjeti tip “Ford Focus”, me targa ***, është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, me vlerë blerjeje 800 euro, ku 70 euro janë paguar për taksën e çregjistrimit dhe 46,169 lekë janë paguar për tarifën doganore. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e krijimit as në DIPP-në e vitit 2016 dhe as në deklaratën *Vetting*. Kjo pasuri është përfituar me anë të faturës¹⁴ së shitjes nr. ***, datë 12.7.2016, të lëshuar nga shoqëria shitëse “***”, me seli në Itali.
22. Njëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime mbi burimin e krijimit të pasurisë, i cili, në përgjigje të tij, ka bërë me dije se burimi i krijimit ka qenë nga të ardhurat nga paga, ndërsa shpenzimet e tjera të kryera për këtë automjet si transporti, regjistrimi dhe siguracioni janë siguruar nga kursimet prej pagës dhe nga kredia e marrë prej tij në “Raiffeisen Bank”.
23. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin dhe informacionin si vijon:
 - i. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2020, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Pina, ka të regjistruar automjetin tip “Ford Focus”, me targa ***, me nr. shasie ***, duke bashkëlidhur edhe dosjen e automjetit¹⁵.
 - ii. Faturë shitjeje nr. ***, datë 12.7.2016, me vlerë 800 euro, lëshuar nga shoqëria shitëse “***”, me kod fiskal ***.
 - iii. Aktzhdoganimi i datës 18.7.2016, për automjetin tip. “Ford Focus”, me vit prodhimi 2003, i dërguar nga Italia nga eksportuesi “***” dhe marrës subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Pina, në të cilën ka rezultuar edhe pagesa e tarifës doganore prej 46,169 lekësh.
 - iv. AMF-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2020, ka konfirmuar mbulimin me sigurim të automjetit në fjalë nga subjekti i rivlerësimit, duke filluar nga data 15.8.2016.

2.1. Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie

24. Ndonëse nga subjekti i rivlerësimit nuk është specifikuar burimi i krijimit të kësaj pasurie as në DIPP-në e vitit 2016 dhe as në deklaratën *Vetting*, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni është konstatuar kryerja e një transferte të shumave në datën 6.7.2016, nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në monedhën euro në “Raiffeisen Bank”, në favor të shtetasit G. B., me përshkrimin “blerje makinë Ford Focus me nr. shasie ***”, në shumën 894.4 euro.

¹⁴ Faturë në gjuhën italiane, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

¹⁵ DPSHTRR-ja ka bashkëlidhur gjithashtu dosjen e automjetit tip “Toyota Auris”, me targa ***, e cila është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 11.12.2020, me palë shitëse shtetasin N. S., kundrejt çmimit total 5,700 euro. Gjithashtu, DPSHTRR-ja ka bashkëlidhur dosjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, të regjistruar në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, e cila ka dalë nga qarkullimi përfundimisht në datën 31.10.2011, me kërkesë të babait Dh. P..

25. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektin, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, shpjegime mbi arsyen e transferimit të shumës së mësipërme në favor të shtetasit G. B. , ndërkohë që shitësi i automjetit ka qenë shoqëria “***”. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se: *“Nuk kam pasur dhe as nuk kam ndonjë njohje apo kontakt me shtetasin e quajtur B. G.. Thjesht më kanë nisur numrin e llogarisë dhe kam kryer pagesën, pa i kushtuar shumë rëndësi emrit të subjektit përkatës. Unë nuk kam njohuri për formën e regjistrimit të subjektit tregtar shitës në shtetin Italian, si funksionon konkretisht regjimi juridik i subjekteve tregtare, sistemi i pagesave në atë vend, etj., prandaj nuk mund të flas me siguri, por duke qenë se shoqëria “***” dhe ‘B. G.’ kanë një të dhënë të përbashkët, mendoj se shtetasi B. G. mund të jetë ortak i shoqërisë, administrator i saj, etj.”*
26. Nga lëvizjet bankare të llogarive të subjektit të rivlerësimit është konfirmuar këmbimi valutor i kryer në datën 6.7.2016, mes llogarive të subjektit, nga ku shuma e disponuar më parë në llogarinë e tij të pagës prej 123,750 lekësh është konvertuar në 900 euro. Gjithashtu është konfirmuar edhe krijimi i kësaj gjendjeje në llogarinë e pagës nga të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nga lëvizjet bankare është konfirmuar edhe marrja e kredisë bankare në shumën 103,000 lekë, në datën 28.7.2016, në “Raiffeisen Bank”.
27. Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektin të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me dinamikën e njohjes me palën shitëse, si dhe duke i kërkuar edhe referenca specifike për të provuar aktivitetin e shoqërisë shitëse “***” në Itali. Në përgjigje të sa më sipër i ishte kërkuar, subjekti ka bërë me dije se miku i tij, av. I. D., kishte një të afërm në Parma, Itali, i cili do të merrej me gjetjen dhe procedurat e nevojshme për dërgimin e automjetit. Subjekti ka pohuar se ky i fundit, nëpërmjet mikut të tij, i ka dërguar numrin e llogarisë për të kryer pagesën. Subjekti ka shtuar gjithashtu se për shkak të angazhimeve në punë ka lëshuar një prokurë të posaçme mikut të tij për të ndjekur të gjithë procedurat e zhdoganimit dhe regjistrimit të automjetit. Subjekti ka paraqitur, së bashku me përgjigjet e mësipërme, prokurën e posaçme nr. ***, datë 13.7.2016, të lëshuar për shtetasin I. D..
28. Lidhur me ekzistencën e mundshme të marrëdhënieve shoqërore apo të ekzistencës së ndonjë konflikti të mundshëm të interesave, Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 11.2.2021, informacion mbi çështje të mundshme të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, me palë ndërgjyqëse shtetasit B. G., A. G. apo shoqërinë “***”, me kod fiskal ***. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2021, ka bërë me dije se për palët e sipërpërmendura, nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, nuk ka rezultuar ndonjë vendim i dhënë nga kjo gjykatë.
29. Lidhur me përdorimin e disa automjeteve nga subjekti i rivlerësimit për udhëtime të ndryshme, siç ka rezultuar nga të dhënat e sistemit *TIMS*, Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë të bënte me dije nëse ka pasur ndonjë çështje të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, me palë ndonjërin nga pronarët e automjeteve në fjalë¹⁶. Kjo e fundit, me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2021, ka bërë me dije se për shtetasit e përmendur në shkresën e Komisionit nuk ka pasur çështje të gjykuara nga gjykata. Ndërsa për shtetasin M.

¹⁶ U. B., E. N., shoqëria “***”, D. R. R., I. C. S. dhe V. B..

Ç.¹⁷ ka rezultuar të jenë dhënë këto vendime: vendimi nr. ***, datë 18.9.2018 (gjuqtare K. B.); vendimi nr. ***, datë 24.4.2018 (gjuqtar N. D.); vendimi nr. ***, datë 18.10.2019 (gjuqtar E. D.). Pra, asnjëra nga këto çështje nuk ka rezultuar të jetë shqyrtuar/gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

30. Po ashtu, Komisioni i ka kërkuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) informacion lidhur me ekzistencën e ndonjë hetimi, çështjeje penale të regjistruar ose vendim mosfillimi apo pushimi, në emër të shtetasve me të cilët subjekti kishte udhëtuar. SPAK-u, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021, ka bërë me dije se në emër të këtyre personave nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal më herët apo aktualisht.
31. Trupi gjykues, nisur nga sa më sipër dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, ka konkluduar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit dhe të deklarimit të kësaj pasurie, ndërsa mosdeklarimi në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting* të burimit financiar të shumave të paguara për këtë pasuri – ndonëse përbën një pasaktësi në deklaratimet përkatëse – çmon se ajo në vetvete nuk konsiderohet e një niveli të tillë që të përbëjë një shkak për aplikimin e ndonjë mase ndaj subjektit të rivlerësimit.

3. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”

32. Nga dokumentacioni i administruar lidhur me lëvizjet bankare të llogarive të subjektit të rivlerësimit është konfirmuar gjendja në llogaritë bankare të subjektit, përkatësisht në shumat 74,681 lekë dhe 5 euro, të cilat përputhen me shumat e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe është konfirmuar burimi i krijimit të tyre nga të ardhurat nga pagat.
33. Gjithashtu, lidhur me lëvizjet bankare, DPPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020, ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar raportime nga bankat në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Pina.
34. Trupi gjykues, nisur nga sa më sipër, vlerëson se deklaratimet e subjektit lidhur me gjendjet në llogarinë e tij bankare përputhen me dokumentacionin e administruar, si dhe nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të tyre, për sa kohë kanë rezultuar të siguruara nga burime të ligjshme financiare.

4. Investime të kryera nga subjekti i rivlerësimit, pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*

35. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar nga DPSHTRR-ja shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2020, me të cilën është përcjellë dosja e automjetit tip “Toyota Auris”, i cili ka rezultuar të jetë blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën e shitblerjes nr. ***, në datë 11.12.2020, nga pala shitëse N. S.¹⁸, kundrejt çmimit 5,700 euro. Ky informacion është konfirmuar edhe nga përgjigjet e dhëna prej subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 1, ku burimi i krijimit për blerjen e automjetit në fjalë është deklaruar nga kursimet e tij dhe

¹⁷ Shtetasi M. Ç. rezulton të ketë qenë ekspert topograf në çështjen që i përket dosjes nr. 1, të trajtuar në seksionin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

¹⁸ Nga dosja e automjetit ka rezultuar se shtetasi N. T. S. e ka blerë këtë automjet me anë të kontratës (e nënshkruar jo në prani të noterit) së datës 10.12.2020, nga pala shitëse “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor A. T. S., kundrejt çmimit 227,000 lekë. Kjo shoqëri ka blerë automjetin nga shoqëria e huaj “****” s.r.s., në datën 15.10.2020, kundrejt çmimit 1,450 euro, si dhe ka paguar tarifën e zhdoganimit në vlerën 43,666 lekë.

nga paga.

36. Gjithashtu, nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit në DIPP-të e viteve 2017 dhe 2018, si dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk ka rezultuar ndonjë investim tjetër i mëpasshëm. Ndërkohë që nga verifikimi i dokumentacionit të administruar lidhur me llogaritë bankare të subjektit, ka rezultuar se deri në nëntor të vitit 2020 ka përfituar të ardhura nga paga¹⁹ në shumën 2,149,275 lekë. Po ashtu, gjendja e mbetur në llogarinë bankare të pagës së subjektit në datën 20.11.2020, ka qenë në shumën 1,291,522 lekë.
37. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank” ka rezultuar se subjekti ka tërhequr *cash* (deri në datën 20.11.2020) shumën 961,730 lekë. Pas zbritjes së shpenzimeve jetike për të njëjtën periudhë (janar – nëntor 2020), si dhe përlllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimeve²⁰, shpenzimeve të qirasë²¹ dhe shpenzimeve të sigurimit të automjetit²² përgjatë kësaj periudhe, ka rezultuar se subjekti mund të dispononte kursime në shumën 576,162 lekë, me burime të ligjshme financiare, siç është detajuar në tabelën e mëposhtme – të dhënat e të cilës janë përlllogaritur nga Komisioni me rezervë, për sa kohë në momentin e mbylljes së hetimit administrativ, mungonin të dhënat mbi të ardhurat dhe lëvizjet e mundshme lidhur me muajin dhjetor të vitit 2020.

Tabela mbi analizën e burimeve për blerjen e automjetit në vitin 2020

| | | |
|--------------------------------------|---|----------------|
| Terheqje cash janar - nentor 2020 | | 961 730 |
| Shpenzime jetese janar - nentor 2020 | - | 244 482 |
| Shpenzime udhetimi | - | 12 316 |
| Shpenzime qiraje | - | 110 000 |
| Shpenzime per siguracion automjeti | - | 18 770 |
| Shpenzime per blerjen e automjetit | - | 703 950 |
| Rezultati | - | 127 788 |

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

38. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatin e sipërpërshkruar – për të cilin i ishte kaluar barra e provës – nëpërmjet shpjegimeve të tij që ka depozituar përpara seancës dëgjimore, por edhe përgjatë kësaj të fundit, ka kundërshtuar analizën financiare të kryer për këtë pasuri dhe ka kërkuar që të merren në konsideratë edhe tërheqjet e kryera nga subjekti gjatë periudhës 21.11.2020 – 11.12.2020, pra, deri në datën që është kryer pagesa e çmimit për blerjen e automjetit në analizë. Për këtë qëllim, subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, dokumentin bankar me lëvizjet monetare të llogarisë së tij në “Raiffeisen Bank”, deri në fund të vitit 2020.

Vlerësimi i trupit gjykues

¹⁹ Pa përfshirë dietat e përfituara nga subjekti gjatë vitit.

²⁰ Nga kontrolli i hyrje-daljeve sipas sistemit *TIMS* ka rezultuar se gjatë vitit 2020 subjekti i rivlerësimit ka dale nga Shqipëria vetëm në datën 25.1.2020 dhe ka hyrë sërish në të njëjtën datë.

²¹ 11 muaj * 10,000 lekë/muaj.

²² Nga kërkimi në faqen zyrtare të www.amf.gov.al ka rezultuar se policia e sigurimit TPL të prerë për automjetin me targa ***, në vitin 2020, ka qenë në vlerën 18,770 lekë.

39. Komisioni, pasi ka analizuar dokumentacionin lidhur me lëvizjet bankare të paraqitura nga subjekti, ka konstatuar ekzistencën e disa shumave *cash* të tjera të tërhequra prej tij, mes të cilave është evidentuar edhe një tërheqje e kryer pikërisht në datën e blerjes së automjetit, në shumën 702,000 lekë, e cila përputhet me çmimin e blerjes 5,700 euro.
40. Në konkluzion, trupi gjykues – duke mbajtur në vëmendje pretendimet e subjektit dhe pasi ka vlerësuar arritjen e një niveli bindës të shpjegimeve të tij, si dhe vlerën provuese të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe të administruar nga Komisioni, lidhur me burimin e ligjshëm të shumave monetare të disponuara në llogarinë rrjedhëse të lartpërmendur, të disponuara dhe të përdorura nga subjekti për blerjen e automjetit tip “Toyota Auris” në datën 11.12.2020 – çmon se kjo pasuri është blerë tërësisht me burime të ligjshme dhe është deklaruar në mënyrë të saktë.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

41. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në aneksin nr. 1 që i bashkëlidhet këtij dokumenti janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës.
42. Në këtë analizë, janë pasqyruar dhe përlllogaritur:
- i. pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit, të pasqyruar në vitin përkatës të kryerjes së investimit, me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin përkatës të kontratave të shitblerjeve;
 - ii. të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës *Vetting*;
 - iii. shpenzimet jetike janë përlllogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT-i;
 - iv. shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve sipas sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit, bazuar në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të KPA-së dhe deklaratimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 1;
 - v. shpenzimet e qirasë janë konsideruar bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve dhe kontratave të qirasë;
 - vi. gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit;
 - vii. detyrimet përfshijnë gjendjen në fund të çdo viti të të gjitha detyrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj bankave të nivelit të dytë – në këtë seksion janë shënuar edhe likuidimet e kryera në vijim, të këtyre detyrimeve, me vlerë negative;
 - viii. kursi i këmbimit i përdorur për të gjitha investimet/shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare

të Bankës së Shqipërisë²³.

43. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2013, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI. Po ashtu, është kryer analiza financiare për vitet 2017, 2018 dhe 2019 me të dhënat që Komisioni ka disponuar, bazuar në dokumentacionin e ardhur nga institucionet që u janë drejtuar përgjatë hetimit administrativ, të cilat i përkasin fundit të vitit 2020 (muaji nëntor). Në analizë janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga subjekti në llogarinë e tij bankare të pagës, shpenzimet e jetesës sipas Anketës së Buxhetit të Familjes të publikuar në faqen zyrtare të INSTAT-it, shpenzimet e kredisë bankare, shpenzimet e udhëtimit sipas sistemit *TIMS*, si dhe sipas përgjigjeve të subjektit në pyetësorin nr. 1. Shpenzimet e qirasë janë konsideruar të njëjta me shpenzimet e vitit të mëparshëm (duke qenë se subjekti vijon të banojë në të njëjtin apartament me qira), si dhe shpenzimet e sigurimit të detyrueshëm të automjetit (sipas informacionit të marrë nga faqja zyrtare e AMF-së). Në përfundim të analizës financiare balanca e përgjithshme mbetet pozitive, siç është detajuar në aneksin nr. 1, në vijim.

Tabela e analizës financiare për periudhën 2013 – 2019

| Viti | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 |
|---|----------------|----------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| PASURI | -1,229 | -416 | 377 | 180,659 | 14,762 | -73,226 | 485,964 |
| Automjet Ford Focus, viti 2003 (AA***C) | | | | 120,985 | | | |
| Ndryshim likuiditeti | -1,229 | -416 | 377 | 59,673 | 14,762 | -73,226 | 485,964 |
| TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR | 802 | 387 | 764 | 60,437 | 75,199 | 1,973 | 487,937 |
| DETYRIME | 0 | 24,629 | -24,629 | 70,426 | -70,426 | 0 | -500,200 |
| Kredi per telefon | | 24,629 | -24,629 | | | | |
| Kredi ne RZB "quick cash loan" | | | | 70,426 | -70,426 | | |
| Dhene hua te vellait G*** P*** | | | | | | | -500,200 |
| PASURI NETO | -1,229 | -25,045 | 25,006 | 110,233 | 85,188 | -73,226 | 986,164 |
| Të ARDHURA dokumentuar | 556,187 | 992,286 | 1,050,047 | 1,283,760 | 1,199,040 | 1,110,862 | 2,342,070 |
| Te ardhura SR vertetuar | 556,187 | 992,286 | 1,050,047 | 1,283,760 | 1,199,040 | 1,110,862 | 2,342,070 |
| SHPENZIME | 261,024 | 396,019 | 476,454 | 530,330 | 510,353 | 487,042 | 545,854 |
| Shpenzime jetese | 141,024 | 219,998 | 224,276 | 235,092 | 238,054 | 246,276 | 266,708 |
| Shpenzime zhdoganimi/transporti te automjetit | | | | 100,277 | | | |
| Shpenzime qiraje | 120,000 | 120,000 | 225,000 | 120,000 | 120,000 | 120,000 | 120,000 |
| Shpenzime komisione dhe interesi te kredive | | | 4,847 | 7,003 | 3,143 | | |
| Shpenzime per blerje telefoni | | 27,999 | | | | | |
| Shpenzime udhetimi | | 28,022 | 22,331 | 52,128 | 130,196 | 101,807 | 140,186 |
| Shpenzime siguracioni | | | | 15,830 | 18,960 | 18,960 | 18,960 |
| Analiza dokumentuar | 296,392 | 621,312 | 548,587 | 643,197 | 603,499 | 697,045 | 810,052 |
| CASH në Lekë | | | | | 35,000 | 18,000 | 160,000 |
| DIFERENCA E PA MBULUAR | | 0 | | | | | |

²³ www.bankofalbania.org

B. KONTROLI I FIGURËS

44. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit një raport për subjektin e rivlerësimit, nr. *** prot., datë 2.11.2017, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Pina, pa disponuar përgjigjen e njërës prej organeve ligjzbatuese.
45. Në vijim të kërkesës së Komisionit për një përditësim në datën 11.1.2021, është përcjellë nga DSIK-ja raporti vijues nr. *** prot., datë 28.12.2020, nëpërmjet të cilit Grupi i Punës nuk e ndryshon konstatimin mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Pina. Gjithashtu, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se dy raportet e sipërcituar janë deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datën 6.1.2021, të KDZH-së.
46. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese dhe përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte/rrethana të reja për subjektin e rivlerësimit, lidhur me këtë kriter, që mund të ngrinin dyshime mbi bazueshmërinë e konkluzioneve të arritura nga DSIK-ja. Për rrjedhojë, trupi gjykues e ka vlerësuar të përshtatshëm subjektin e rivlerësimit për vijimin e detyrës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

47. Komisioni në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Pina, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLGJ-ja dhe të përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 29.5.2020; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese – burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja

48. Në raportin e KLGJ-së janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative; (iii) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (iv) aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Raporti në fjalë është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iv) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.
49. Sipas këtij raporti: (i) subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Pina, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për

mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në një rast, është konstatuar se gjyqtari *ka shkelur dispozitat procedurale të këtij ligji, sikundër është afati maksimal prej 48 orësh për gjykimin e kërkesës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes parashikuar në nenin 18/1 të këtij ligji, duke e gjykuar për një afat prej 66 orë dhe 52 minuta²⁴*; (ii) gjyqtari përgjithësisht përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të së drejtës si parimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, parimin e disponibilitetit të padisë, si dhe parimin e përgjegjësisë penale me faj. Lidhur me praktikën gjyqësore të gjykatave më të larta konstatohet se ajo është përdorur kryesisht tek tri dokumentet e paraqitur nga subjekti, kjo për shkak të natyrës së këtyre gjykimeve²⁵; (iii) subjekti i rivlerësimit ka aftësi procedurale, ndjek procedurën e parashikuar nga ligji, duke disponuar me vendime të ndërmjetme dhe urdhra ndaj kërkimeve të palëve. Në përgjithësi vendimet e ndërmjetme të tij janë të arsyetuara dhe përmbajnë bazë ligjore të shprehur; (iv) vlen të përmendet, se pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, në dy raste janë konstatuar edhe këto gjetje: (a) se përtej analizës ligjore dhe vlerësimit të provave, rezulton se ka marrë në konsideratë efektet e një vendimi gjyqësor civil për të cilin rezulton e provuar në gjykim se është dhënë mbi bazën e akteve të falsifikuara (shihni dokumentin nr. 1); (b) në një rast tjetër, ku objekt gjykimi ka qenë përmbushja e detyrimeve kontraktore midis palëve, gjyqtari nuk ka identifikuar llojin e kontratës së lidhur midis palëve dhe përmbushjen e detyrimeve sipas natyrës së kontratës (shihni dosjen 2); (v) arsyetimi ligjor – subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Pina, ka aftësi në arsyetimin ligjor me cilësi. Në tri dokumentet e paraqitur nga subjekti dhe pesë dosjet e vëzhguara ndiqet metoda e ndarjes së vendimit në pjesë. Gjithashtu, tek të pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme.

50. Nisur nga sa më sipër, konstatohet se vlerësimi i përgjithshëm i kryer nga KLGj-ja ka qenë pozitiv, ndonëse janë ngritur dyshime mbi disa problematika të mundshme mbi mosrespektimin e disa afateve për shqyrtimin gjyqësor dhe vendimmarrjen lidhur me dokumentin nr. 1, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, që është trajtuar edhe nga Komisioni – si në vijim të vendimit.

C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

²⁴Shkaku rezulton të jetë mosmarrja dijeni e paditëses për datën dhe orën e gjykimin, ndërsa në shkeljen e afatit duket se ka ndikuar dhe planifikimi i seancës së parë në kufijtë e afatit, duke e planifikuar për 47 orë dhe 30 minuta. Konstatohet se data për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes më 7.5.2016, është caktuar në zbatim të afatit ligjor 20-ditor të parashikuar në nenin 19/3/d, të ligjit nr. 9669/2006, dispozitë në të cilën është parashikuar se vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe, ndër të tjera, duhet të përmbajë datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate. Rezulton se lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes është bërë në datën 2.5.2016, ndërsa vërtetimi i tij është bërë në datën 7.5.2016, duke respektuar afatin 20-ditor.

²⁵Kështu në funksion të zbatimit të ligjit gjyqtari citon nenin 1 të protokollit nr.1 të KEDNJ-së, ka përdorur referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë: vendimet nr. 5/2011 dhe nr. 1/2009 mbi natyrën dhe elementët e padisë së rivendikimit si dhe legjitimiteti i palëve ndërgjyqëse në padinë e rivendikimit (shihni dokumentin 1). Gjyqtari referon në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 43/2011, si dhe në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë me nr. 5/2011 dhe nr. 4/2013, mbi natyrën *sui generis* të vendimeve të KKKP-së (shihni dokumentin 2). Ndërsa në zgjidhjen e një çështje civile gjyqtari referon në praktikat jounifikuese të Gjykatës së Lartë mbi plotësimin e kushteve për fitimin e pronësisë me bashkim dhe përzierje (shihni dokumentin 3). Në vendimin penal të vëzhguar në funksion të aplikimit të gjykimin të shkurtuar gjyqtari referon në vendimin nr. 4/2012, të Gjykatës Kushtetuese, si dhe në vendimin unifikues nr.2/2003. Në çështjen urgjente të dhunës në familje gjyqtari citon detyrimet e Shqipërisë referuar Konventës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave e dhunës në familje” (shihni dosjen 3).

51. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGj-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku, si dhe duke analizuar aktet/vendimet/dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
52. Lidhur me dokumentin nr. 1, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pranë ish-KLD-së, i sipërcituar, i referohet vendimit civil nr. ***, datë 1.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që i përket paditësit V. V., kundër të paditurve Rr. L., etj., me objekt “lirim dhe dorëzim sendi”, ku veç të tjerash, në faqen 7 të vendimit, subjekti shprehet se: “[...] arsyetohet mbi efektet e një vendimi gjyqësor të vitit 2006, me të cilin është disponuar në këtë vendim, mbi konstatimin absolutisht të pavlefshëm të një akti administrativ të vitit 2002, me anë të të cilit trashëgimlënësit të paditësit i ishte hequr një sipërfaqe toke e dhënë me anë të një akti të mëparshëm administrativ (AMTP e vitit 1994)”.
53. Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, Komisioni ka konstatuar se me anë të një vendimi tjetër gjyqësor, është provuar se kërkesëpadia, e cila ka vënë në lëvizje gjykatën, për interes të trashëgimlënësit të paditësit – për konstatimin e pavlefshmërisë së AMTP-së, është deklaruar *pjesërisht e pavërtetë për shkak se prokura e lëshuar në emër të avokatit të paditësit ka rezultuar e falsifikuar*. Në këtë vendim është çmuar se të paditurit pas këtij fakti, *duhej të kishin kërkuar rishikim të vendimit gjyqësor të 2006, të formës së prerë, gjë e cila nuk ka rezultuar të jetë kërkuar*.
54. Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 1.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të orientuar palët në zgjidhjen e çështjes në fjalë. Gjithashtu, ka rezultuar se vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është ankimuar në Gjykatën e Apelit Gjjirokastrë, e cila me vendimin e datës 11.10.2016, ka vendosur *lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë*. Nga hulumtimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë nuk ka rezultuar që të ishte e regjistruar në listën e çështjeve ndonjë rekurs me palë ndërgjyqëse ato të lartpërmendura.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

55. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit lidhur me këtë pikë, veç të tjerash, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *së pari kemi të bëjmë me mënyrën e interpretimit të ligjit, çka është çështje e kontrollit nga gjykatat më të larta; së dyti: sa i përket detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit, subjekti i rivlerësimit është shprehur se nga ana e tij në rigjykim janë zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit, çka rezulton nga vendimi i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, në rast të kundërt nëse do të kishte konstatuar një gjë të tillë, ajo në zbatim të nenit 467/a&2 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të kishte prishur vendimin dhe të vinte në dukje shkeljen, gjë që nuk rezulton të jetë bërë; së treti: lidhur me orientimin e palëve për mënyrën e zbatimit apo interpretimit të ligjit, subjekti i rivlerësimit është shprehur se gjyqtari e ka të ndaluar të orientojë palët për mënyrën se si duhet ta interpretojnë ligjin apo zbatojnë atë se si duhet të mbrohet në gjykim. Pasi palët e dispononin vendimin e Gjykatës, dhe si detyrë në gjykimin e shkallës së parë në rigjykim, subjekti duhet të zbatonte detyrat konkrete, të cilat i ka zbatuar*.

56. Lidhur me interpretimin e vendimit, subjekti ka sqaruar se nuk bëhet fjalë për interpretim të gabuar të ligjit me qëllim favorizimin e palës paditëse, pasi edhe pse ka legjitimuar këtë të fundit në proces, ka vendosur “rrezimin e padisë”. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk mund të orientonte palët se duhet të kërkonin rishikimin e vendimit përkatës apo ndonjë orientim tjetër konkret, pasi do të tejkalonte rolin dhe do të shfaqte mendim para dhënies së vendimit përfundimtar, çka do të përbënte shkelje.

Vlerësimi i trupit gjykues

57. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit kanë rezultuar pjesërisht bindëse dhe konkretisht ato të dhëna përgjatë seancës dëgjimore, lidhur me tipologjinë e objektit të çështjes të gjykuar nga subjekti, ku vendimmarrja nuk ndikohej nga dispozitivi i vendimit të dhënë në çështjen e vesuar nga prokura e përfaqësuesit ligjor me një firmë jo autentike të palës paditëse. Pa hyrë në vlerësimin e themelit të vendimmarrjes, Komisioni çmon se për sa i takon (mos)plotësimin të veprimeve të përshkruara nga Gjykata e Apelit, nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 5.1.2016, ndonëse nuk ka pasur në mënyrë qartë një urdhër për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, nga arsyetimi i këtij vendimi shprehet nevoja e orientimit të palëve lidhur me një zgjidhje përfundimtare dhe në kontraditet, të problematikës pasurore që ndërthuret me vendimin e vitit 2006 – fryt ky i një çështje të vesuar nga një problem procedural mbi legjitimitimin e përfaqësuesit ligjor – për sa kohë këtë vendim gjyqësor subjekti e ka përdorur në arsyetimin e tij lidhur me vlefshmërinë e AMTP-ve të shqyrtuara, pa u shqetësuar për faktin se një vendim i vesuar nga këndvështrimi formal do të duhej të gjente një rishqyrtim shterues nëpërmjet institutit të rishikimit. Nisur nga ky kontekst, subjekti do të duhej të kishte orientuar palët për një adresim përfundimtar të mosmarrëveshjes, përtej vendimmarrjes së tij – nëpërmjet një arsyetimi më të gjerë e të plotë të vendimit nr. ***, datë 1.7.2016 dhe natyrisht jo përgjatë shqyrtimit gjyqësor, për sa kohë orientimi nuk lidhej dhe as kufizohej brenda perimetrit të objektit të padisë që subjekti ka shqyrtuar.
58. Në përfundim, trupi gjykues – ndonëse ka konstatuar se subjekti nuk ka qenë shterues në gjykimin e sipërpërshkruar dhe në arsyetimin jo gjithëpërfshirës të vendimit përkatës, lidhur me orientimin e palëve (pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe nëpërmjet argumentimit të vendimit përfundimtar), mbi mënyrat dhe hapat që mund të ndërmerreshin prej tyre për adresimin e problematikës pasurore shumëvjeçare – çmon se kjo rrethanë nuk rezulton e mjaftueshme për ta cilësuar atë si një mangësi e rëndë apo në një nivel paaftësie profesionale.

DENONCIME NGA PUBLIKU

59. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, deri në këtë fazë të hetimit, janë paraqitur nga publiku 13 denoncime (3 denoncime janë nga i njëjti denoncues), të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Pina. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka rezultuar se nga përmbajtja e një pjese të denoncimeve të administruara nuk janë evidentuar prova mbi shkelje të mundshme apo *indicie* mbi të cilat mund të kryhej ndonjë hap hetimor i

mëtejshëm nga Komisioni, ndërsa mbi disa të tjerë janë kryer hetime të thelluara dhe janë administruar dokumente e informacione shtesë, sipas rastit si në vijim.

1. Denoncimi nr. * prot., datë 8.2.2018, i shtetasit E. S.**

60. Shtetasi E. S. akuzon disa subjekte rivlerësimi, ndërmjet tyre edhe gjyqtarin Sokol Pina, për mosrespektim formal të ligjit dhe në mungesë të provave ka marrë e vendimit penal nr. ***, datë 31.7.2017, për caktimin e masës së sigurimit “*arrest me burg*” ndaj tij. Ankesa është depozituar edhe në ish-KLD, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2017, ka vendosur arkivimin, pasi pretendimet ishin jashtë objektit të veprimtarisë dhe ato mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet apelimit. Nga shqyrtimi i vendimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka vendosur “pranimin e kërkesës dhe vleftësimin si të ligjshëm të ndalimit të personit nën hetim E. S.”, duke caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Më pas, Prokuroria e Rrethit Sarandë ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest me burg” në “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”, kërkesë kjo e pranuar edhe gjykata me vendimin nr. ***, datë 16.2.2017, pasi organi i akuzës kishte vlerësuar se hetimet ndaj shtetasit E. S., duhet të pushohen. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila me vendimin nr. ***, datë 3.3.2017, ka vendosur “pushimin e shqyrtimit të çështjes penale nr. ***, datë 31.1.2017”.
61. Nga sa më lart, nuk janë gjetur elemente mbi të cilët mund të thellohej hetimi administrativ mbi këtë çështje, për sa kohë ndryshimi i masës së sigurisë nga subjekti i rivlerësimit, duket në përputhje me ecurinë e rezultateve të hetimit të çështjes në fjalë, si dhe me konkludimin e saj me vendimin për pushimin e hetimit ndaj denoncuesit (që është miratuar dhe konfirmuar edhe nga vlerësimi i mëpasshëm i gjykatave), si dhe nuk ka rezultuar të jenë kryer shkelje të dispozitave ligjore apo nënligjore nga subjekti i rivlerësimit.

2. Denoncimi nr. * prot., datë 3.7.2018, i shtetasës R. B.**

62. Shtetasja R. B. ka depozituar një ankesë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, në KLD dhe në Prokurorinë e Përgjithshme, duke ngritur pretendime për shkelje ligji nga trupa gjyqësore përbërë nga gjyqtarët A. Z., A. S. dhe Sokol Pina²⁶, i cili kishte qenë edhe relator. Ankuesja përshkruan disa shkelje procedurale të ndërmarra në keqinterpretim të ligjit, si: “(a) cilësim të gabuar të veprës penale dhe, për pasojë, përfitimin nga i pandehuri të faljes në masën 1/3 të dënimit; (b) nuk është lejuar marrja e provave të reja dhe thirrja e dëshmitarëve; (c) në kundërshtim me ligjin, gjykata ka pranuar kërkesën e të pandehurit për gjykimin e shkurtuar; (d) trupa nuk ka pasur njohuri mbi dosjen gjyqësore pasi nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për njohjen fizike; (e) nuk është shprehur për padinë civile, nuk ka pranuar pretendimet e avokatit të viktimave që t’i dorëzonte ato në seancën përfundimtare; (e) subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Pina, relator i çështjes, ka shkelur solemnitetin e gjykimit, ka cenuar rëndë procesin e rregullt ligjor, ka cenuar rëndë figurën e gjyqtarit dhe besimit të publikut, pasi sipas saj ka shfaqur, njëanshmëri në proces, nuk i ka lejuar të drejtën e fjalës duke shkelur një nga parimet kryesore”.
63. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Sarandë, me vendimin nr. ***, datë 21.6.2018, ka vendosur “deklarimin fajtor të shtetasit

²⁶Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dalë me vendimi pakicë për gjykimin e shkurtuar.

S. Xh., dënimin e tij me 18 vjet burg etj.”, vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër, e cila me vendimin nr. ***, datë 21.6.2018, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, mospranimin e ankimit të trashëgimtarëve të viktimës (ankueses), për të cilët vendimi ka marrë formë të prerë që në datën 9.7.2018”.

64. Komisioni mori në analizë pretendimet e ankueses, nga ku rezultoi se lidhur me kualifikimin e veprës penale, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë kishte paraqitur procedimin penal kundër të pandehurit S. Xh. duke kualifikuar veprën penale “vrasja me paramendim”, “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, kërkesë e pranuar nga gjykata me vendimin nr. ***, datë 6.12.2017, nga një tjetër subjekt rivlerësimi. Në këtë seancë gjyqësore paraprake ka qenë vetë i pandehuri që ka kërkuar me shkrim që të procedohet me gjykim të shkurtuar sipas nenit 332/c/3 të Kodit të Procedurës Penale, duke kaluar kështu çështjen për gjykim.
65. Lidhur më kërkesën për “gjykim të shkurtuar”, gjykata, pasi ka marrë deklarinimin me shkrim të të pandehurit, ka kryer edhe një analizë të thelluar të shkaqeve, natyrës dhe veçorive të gjykimit të shkurtuar, duke vlerësuar dhe argumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, se çështja penale mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, pasi i pandehuri kishte kërkuar gjykimin e shkurtuar, vendim ky i marrë nga gjykata me shumicë.
66. Për sa i takon pretendimit se “*trupa gjyqësore nuk është shprehur për padinë civile*”, nga shqyrtimi i vendimit dhe i procesverbaleve ka rezultuar se avokati i të pandehurit, ka kërkuar veçimin e padisë civile²⁷ nga ajo penale. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në zbatim të Kodit të Procedurës Penale, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur më parë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën kompetente, duke u shprehur edhe për të drejtën e ankimit së bashku me vendimin përfundimtar.
67. Lidhur me pretendimin se “*nuk është lejuar të merren provat dhe të thirren dëshmitarët*”, ka rezultuar se gjykata ka pranuar kërkesën e të pandehurit “për gjykim të shkurtuar” në zbatim të procedurës së Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet se: “*Kur procedohet me këtë lloji gjykimi, shmanget faza e hetimit gjyqësor, faza e marrjes dhe debatimit të provave dhe fashikulli i prokurorit kthehet në dosje gjyqësore, si dhe të gjitha provat e grumbulluara gjatë hetimeve paraprake pranohen nga palët si të vërteta. Palët nuk mund të pretendojnë pavlefshmërinë e akteve, apo papërdorshmërinë e akteve dhe nuk mund të kërkojnë marrjen e provave të reja, përveç atyre që lidhen më personalitetin, gjendjen personale dhe familjare të të pandehurit*”. Referuar procesverbaleve gjyqësore deri në datën e zhvillimit të seancës gjyqësore, palët nuk kishin arritur të paraqesin një dokument të tillë, fakt ky i pohuar në seancë edhe nga vetë organi i akuzës. Në seancën gjyqësore të datës 21.6.2018, ora 12:22, avokati i viktimave, ka kërkuar marrjen e prova të reja, thirrjen e dëshmitarëve, si dhe ka kërkuar të mos pranohet kërkesa për “gjykim të shkurtuar”.
68. Për sa i takon “*cenimin e procesit të rregullt ligjor*”, nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se në seancën gjyqësore të datës 21.6.2018, ora 12:44, kur organi i akuzës

²⁷ Padi e paraqitur më parë është gjykuar nga një tjetër trupë gjyqësore me vendimin nr. ***, datë 20.3.2019, e cila ka pranuar padinë vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër me vendimin nr. ***, datë 21.1.2020.

parashtronte pretendimet përfundimtare në sallë janë krijuar disa situata që kanë prishur qetësinë e rendin dhe personat janë shoqëruar nga forcat e policisë jashtë ambientit. Më pas, gjykata ka pyetur avokatin e viktimave lidhur me *qëndrimin e tij përfundimtar*, i cili është shprehur *se i duhet më shumë kohë për t'i paraqitur me shkrim pretendimet përfundimtare*, por gjykata e këshilluar në vend ka vendosur të *mos e pranojë kërkesën*, pasi gjykimi ishte i shkurtuar dhe se ka pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur qëndrimin, duke u tërhequr për vendim, *në këtë moment rezulton se avokati i viktimave ka kërkuar të sqarojë trupën gjykuese, por subjekti i rivlerësimit, ka relatuar se gjykata është tërhequr për vendim dhe pas kthimit të trupës gjykuese, është relatuar në procesverbal se avokati i viktimave është larguar.*

69. Në përfundim, gjykata ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit S. Xh. dhe dënimin e tij përfundimisht më 18 vjet burgim²⁸. Referuar procesverbalit të datës 21.6.20218, ora 1:05:03, citohet se: *“Av. Mav. N., ka sqaruar se ka konkluzionin me shkrim dhe se gjykata ka vendosur të mos pranojë kërkesën”*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

70. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, lidhur me përmbajtjen e këtij denoncimi, subjekti ka shprehur sa vijon: *“[...] në thelb nuk është cenuar ndonjë e drejtë procedurale e trashëgimtarëve të viktimës, pasi ata e kishin shprehur që më parë qëndrimin e tyre për çështjen, në një sërë parashtrimesh me gojë dhe shkrim. Ne e kemi dënuar të pandehurin sipas akuzës së ngritur, duke caktuar dënim maksimal për të dhe vendimi është konsideruar i bazuar edhe nga Gjykata e Apelit. Pra, nuk ka asnjë favorizim ndaj këtij të fundit apo cenim të drejtësisë. Kështu çdo pretendim për njëanshmëri ndaj meje apo anëtarëve tjerë të trupit gjykues është i pabazuar. Për më tepër, që gjithë kundërshtimi i ankuesve ka qenë mbi aplikimin e gjykimit të shkurtuar, që është marr me shumicë votash, ku unë kam dal në pakicë. Kështu, nëse mund të diskutohet “njëanshmëria” prej meje, ajo nuk mund të jetë kurrësi në drejtim të të pandehurit. Pretendimi se kam shkelur solemnitetin e gjykimit nuk është i bazuar pasi pranimi ose mos pranimi i një kërkesë, apo qoftë edhe mos disponimi me vendim për ndonjë kërkesë, nuk mund të konsiderohet cenim i “solemnitetit të gjykimit”. Edhe pse isha kryesues i seancës, çdo vendim i ndërmjetëm është marrë në mënyrë kolegjiale, përfshirë edhe atë për t'u tërhequr për marrjen e vendimit përfundimtar (të këshilluar në vend). Kështu, si trup gjykues kemi vendosur të tërhiqemi dhe nuk bëhet fjalë për ndonjë shkelje të kryer nga unë si kryesues [...]”*.

Vlerësimi i trupit gjykues

71. Trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se shpjegimet e tij kanë rezultuar bindëse dhe se në çështjen në analizë nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 21.1.2019, i shtetasit B. B.**

²⁸Referohuni diapozitivit të vendimit nr. *** 21.056.2018.

72. Shtetasi B. B. pretendon se vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është i padrejtë, pasi ky i fundit ka ndërruar qëllimisht disa herë ekspertët në mënyrë të tillë që denoncuesi të dënohej. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2021, ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 27.4.2017, i cili ka “shpallur të pafajshëm shtetasin T. P.”, vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, e cila me vendimin nr. ***, datë 17.10.2017, e ka “lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”, vendimi është ankimuar në Gjykatën e Lartë me nr. çështje ***, datë 1.2.2018 dhe është aktualisht në fazën e studimit.
73. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se gjykata në mënyrë të qëllimshme ka thirrur disa ekspertë të fushës autoteknike dhe të mjekësisë ligjore, u konstatua se në faqen nr. 4 dhe 5 të vendimit, i pandehuri ka kërkuar gjatë seancës gjyqësore që të dyja aktet e ekspertimit të konsiderohen të pasakta, duke i kërkuar gjykatës kryerjen të riekspertimit. Nga ana tjetër, vetë gjykata gjatë shqyrtimit të akteve të ekspertimit dhe pyetjes si dëshmitar të të dëmtuarit (denoncuesit B. B.), ka vënë re se në aktekspertimin autoteknik nuk janë reflektuar disa rrethana që i dëmtuari (denoncuesi) i ka deklaruar vetëm gjatë gjykimit. Gjithashtu, gjykata ka konstatuar se ekspertët (autoteknik dhe mjeko-ligjor) të caktuar nga organi i akuzës nuk kishin kryer deklaratën e betimit gjatë fazës së hetimeve paraprake, në këto kushte, gjykata ka marrë vendim për kryerjen e riekspertimeve.
74. Në përfundim, ka rezultuar se organi i akuzës ka kërkuar: “*Deklarimin fajtor të pandehurit T. T. dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim*”, ndërkohë që gjykata ndryshe nga sa ka kërkuar prokurori ka vendosur: “*Deklarimin të pafajshëm të pandehurit T. T. për kryerjen e veprës penale ‘shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor’*”²⁹.
75. Nisur nga sa më sipër, Komisioni nuk ka gjetur *indicie* për thellimin e hetimit lidhur me këtë denoncim, për aq kohë sa nga ana substanciale vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, si dhe nga ana procedurale nuk konstatohen problematika, pasi përsëritja e akteve të ekspertimit, me kërkesën e njëjës nga palët në proces, ka qenë në përputhje me dispozitat në nenet 224/a, 226 dhe 229 të Kodit të Procedurës Civile.

4. Denoncimi nr. * prot, datë 18.2.2019, i shtetasit E. S.**

76. Shtetasi E. S. pretendon për vendimmarrje të padrejtë nga subjekti i rivlerësimit në çështjen me palë ndërgjyqëse A. L. dhe të paditur Q. S., dhe për këtë shkak ka depozituar në prokurori kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit në datën 14.2.2019. Në kallëzimin në fjalë pretendohet se çështja është zvarritur nga subjekti i rivlerësimit, për arsye subjektive dhe se nuk ka shqyrtuar për diskutim tërheqjen e vendimit nr. ***, datë 6.6.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke mos u dhënë zgjidhje të gjitha kërtimeve të palës paditëse, si dhe nuk është shprehur për një dokument të falsifikuar. Gjithashtu, denoncuesi shprehet se subjekti i rivlerësimit ka shkelur dispozitat e nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, pasi

²⁹Me argumentimin që vepra të cilësohet si shkelje, minimalisht duhet të vërtetohet plagosja e lehtë e dy personave, ndërsa në këtë çështje nuk u provuar plagosja e rëndë e ndonjë personi apo ndonjë pasojë tjetër dhe as plagosja e lehtë e dy ose me shumë personave, por vetëm ajo e shtetasit B. B. (denoncuesi).

ka shpallur vendimin e paarsyetuar, nuk e ka dorëzuar brenda afatit ligjor, si dhe vendimi nuk i është komunikuar palëve brenda afateve të përcaktuara.

77. Nga dokumentacioni në dispozicion rezultoi se subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 24.12.2018, ka vendosur “rrezimin e padisë të denoncuesit”, ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.7.2020, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”.
78. Lidhur me arsyetimin e vendimit jashtë afateve ligjore, konstatohet se kjo çështje është regjistruar në datën 24.4.2018 dhe ka përfunduar më 24.12.2018, pra, 8 muaj më vonë, *pra, kohëzgjatja e gjyqimit është jashtë afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e” pika 5, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.*
79. Lidhur me mos njoftimin e vendimit palëve, nga shqyrtimin i dokumentacionit dhe dosjes fizike të vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka rezultuar se dëftesat e komunikimit të vendimit nr. ***, datë 24.12.2018, janë firmosur nga një shtetas me emrin E. S. (denoncuesi).
80. Për sa i përket pretendimit të ngritur se subjekti i rivlerësimit nuk i ka dhënë zgjidhje të gjitha kërkimeve të palës paditëse në gjykim, duket se nga analizimi tërësor i vendimit, gjyqtari i ka dhënë qartësisht zgjidhje të gjitha kërkimeve të palës, duke marrë në shqyrtim, ndër të tjera, edhe aktet vendimit të gjykatës (të pretenduara nga denoncuesi si dokumente që gjykata nuk i ka marrë në shqyrtim), ku ndër të tjera, në vendimin e subjektit të rivlerësimit citohet se: “...shkresa është marrë nga vetë gjykata nga dosja gjyqësore e vendimit nr. ***, të vitit 2000. Pra, duke qenë se jemi edhe para faktit se akti me të cilin presupozohet se është marrë leja e ndërtimit është anuluar dhe kjo përbën një faktor shtesë se pala paditëse nuk legjitimohet në kërkimet e saj”, duke arritur në përfundimin se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë.
81. Për sa i takon kallëzimit penal të përshkruar nga denoncuesi, është pyetur subjekti i rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i cili ka shpjeguar se: “Nuk ka pasur njoftim zyrtar për kallëzimin, por duke qenë në cilësinë e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është njohur me një kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për marrje informacioni dhe kërkim dokumentacioni në lidhje me këtë çështje. Pas interesimit ka marrë dijeni se me vendimin e datës 20.3.2019, të prokurorit A. K. i është vendosur ‘mosfillimi i procedimit penal’ (kallëzimi nr. ***). Por ky lloj vendimi përgjithësisht në praktikë i njoftohet vetëm kallëzuesit/viktimës së pretenduar dhe jo personave të cilëve ata i atribuojnë veprën”.
82. Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit, bashkë në përgjigjet e pyetësorit, edhe një kopje të vendimit të mosfillimit lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë 5.3.2019³⁰.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

³⁰ Kallëzimi penal i shtetasve E. S., E. P., S. Z. dhe A. L. kundër shtetasit Sokol Pina, me detyrë gjyqtar për veprën penale “shpërdorim detyre”. Lutemi referojuni dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2

83. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Së pari, rezulton se subjektet kanë paraqitur ankim dhe kanë kërkuar procedimin tim disiplinor edhe pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, i cili me vendimin nr. *** prot., datë 7.2.2021, ka vendosur të arkivoj ankesën. Së dyti, mendoj se kam kryer një hetim të plotë për të gjitha faktet thelbësore ku bazohet vendimi. Kam dhënë një zgjidhje ligjore duke e interpretuar dhe zbatuar ligjin sipas formimit tim profesional. Pretendimi i ankuesve se nuk u kam dhënë zgjidhje të gjitha kërtimeve të palës paditëse në këtë gjykim, pasi nuk jam shprehur për një dokument të falsifikuar, është i pabazuar. Nuk kam pasur objekt të padisë njohjen e pavërtetësisë së ndonjë dokumenti, sipas nenit 32, pika “c”, të Kodit të Procedurës Civile që të kisha detyrimin për t’u shprehur. Nëse nuk do të isha shprehur për të gjitha kërkimet e palëve, Gjykata e Apelit do të kishte prishur vendimin dhe jo ta linte të fuqi. Megjithatë padia është rrëzuar, pasi në thelb kam vlerësuar se e drejta e pretenduar nga paditësit nuk është e bazuar në ligj. Pra, nuk rezultonte legjitimimi aktiv. Së treti, tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk ka ardhur për shkak të ndonjë veprimi të pakujdesshëm ose shkelje të kryer nga unë si gjyqtar, por ka qenë sjellja e palëve me kërkesat e tyre dhe sidomos e institucioneve që nuk kanë kthyer përgjigje në kohë ndaj urdhrave të gjykatës për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar. Ndërsa unë i kam ndërmarrë të gjitha masat ligjore për disiplinimin e procesit dhe zhvillimin e tij brenda afatit të arsyeshëm”.*

Vlerësimi i trupit gjykues

84. Trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se shpjegimet e subjektit kanë rezultuar bindëse, për sa kohë shtyrjet e afatit kanë qenë pasojë e kryerjes së veprimeve procedurale të nevojshme. Për rrjedhojë, vlerësohet se mosrepektimi i afateve, nuk lidhet dhe nuk rrjedh nga mungesa e produktivitetit apo nga neglizhenca e subjektit dhe se në çështjen në analizë nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 10.4.2019, i shtetas K. P.**

85. Denoncuesja akuzon subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të padrejtë dhe shqyrtim të dy çështjeve gjyqësore me objekt padie të njëjtë dhe, për këtë arsye, ka kërkuar përjashtimin e tij. Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për vënien në dispozicion të praktikës, nga ku rezultoi se me vendimin nr. ***, datë 27.09.2017, me objekt: *“Detyrimin e palëve të paditura të njohin vërtetësinë e dokumentit të titulluar marrëveshje mirëkuptimi për pjesëtimin, ndarjen vullnetare të pronës së përbashkët”*, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka vendosur “rrëzimin e padisë”, vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila me vendimin nr. ***, datë 31.5.2018, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”.
86. Më tej, shtetasja K. P. ka depozituar një kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke kërkuar dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit, kërkesa e saj është rrëzuar me vendimin nr. ***, datë 15.3.2019, të dhënë nga gjyqtarja N. D., me argumentimin se *gjyqtari nuk ka mbajtur një qëndrim konkret lidhur me kërkesën e saj, në mënyrë që gjykata ta kishte parasysh, pasi kjo kërkesë ka qenë vetëm në kuadrin e reflektimit të tij, e në këtë*

këndvështrim ligjor, pretendimet e denoncueses ngelen të tilla, duke mos u pranuar nga gjykata.

87. Lidhur me sa është pretenduar për shqyrtimin e dy padive me objekt të njëjtë, ka rezultuar se në kërkesë padinë e parë (që i përket vendimit nr. ***, datë 27.9.2017), objekti i padisë lidhet me vërtetësinë ose jo të një akti/marrëveshje që palët ndërgjyqëse kanë bërë midis tyre, ndërkohë që padia e dytë e ngritur prej saj, ka për objekt të drejtën e b/pronësisë mbi pasurinë objekt konflikti gjyqësor.
88. Për të qartësuar sa më sipër, Komisioni i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë informacion dhe dokumentacion lidhur me padinë/të e ngritura nga denoncuesja K. P. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2021, ka bërë më dije se vendimi gjyqësor (identifikuar si vendimi dytë) nr. ***, datë 17.2.2020, është dhënë nga gjyqtarja S. Xh. duke vendosur “pushimin e çështjes”.
89. Ka rezultuar se kjo çështje është regjistruar përsëri në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, dhe se nga procesverbali i seancave gjyqësore të datës 10.3.2020, *çështja i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Pina, i cili ka kërkuar të ndryshohet si relator me argumentimin se vendimi i sipërcituar, nr. ***, datë 17.2.2020, është dhënë nga gjyqtarja S. Xh. dhe ndaj duhet t'i kalojë kësaj gjyqtareje.* Për rrjedhojë, nuk gjen mbështetje në fakte pretendimi i denoncueses për gjykimin të dy çështjeve nga subjekti i rivlerësimit me të njëjtin objekt padie.
90. Nisur nga sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se nuk janë vërtetuar pretendimet e ngritura nga denoncuesja, lidhur me gjykimin e dy çështjeve me objekt të njëjtë nga i njëjti trup gjyqësor, për rrjedhojë, nuk janë gjetur *indicie* për kryerjen e hapave të tjerë hetimorë lidhur me këtë denoncim, për qa kohë sa nuk ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit të ketë gjykuar çështje me të njëjtin objekt padie – ndryshe nga sa parashtrohej në denoncim në analizë.

6. Denoncimi nr. * prot., datë 4.9.2019, i shtetasit R. S.**

91. Shtetasi R. S. akuzon subjektin e rivlerësimit për zhvillim të seancës gjyqësore pa praninë e tij. Nga dokumentacioni i disponuar ka rezultuar se vendimi nr. ***, datë 25.7.2019, është dhënë nga gjyqtari *në mungesë të palës së paditur.* Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me kërkesë të Komisionit vuri në dispozicion vendimin dhe procesverbalet e seancave gjyqësore, nga shqyrtimi i tyre ka rezultuar se gjyqtari në përputhje me parashikimet ligjore të Kodit të Procedurës Civile ka njoftuar palën e paditur (denoncuesin), i cili pa asnjë shkak të arsyeshëm, si dhe pas ezaurimit të mënyrave të njoftimit të parashikuar nga legjislacioni, nuk është paraqitur dhe, për rrjedhojë, gjykata ka marrë vendim për vazhdimin e gjykimit në mungesë të tij³¹.
92. Nga analizimi i vendimit, ka rezultuar se i padituri brenda afatit të përcaktuar ka paraqitur të ashtuquajturën deklaratën e “mos mundësi për lëshim deklaratë mbrojtëse”, e cila në thelb përshkruan *të metat e kërkesëpadisë*, për të cilat gjykata është shprehur në arsyetimin e vendimit duke i analizuar tërësisht ato. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila me vendimin nr. ***, datë 11.2.2020, ka vendosur “lënien në fuqi të

³¹Gjithashtu, rezulton se në datën 6.6.2019, subjekti i rivlerësimit ka njoftuar edhe me shpallje palën e paditur R. S. (denoncuesin).

vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”, vendimi është rekursuar në Gjykatën e Lartë me nr. ***, datë 22.6.2020, dhe aktualisht është në pritje për t’u gjykuar.

93. Referuar procesverbaleve të disponuara nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka marrë të gjitha masat dhe ka përdorur të gjitha mjetet dhe mënyrat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile për njoftimin e palës paditëse³². Në procesverbalin e datës 23.5.2019, ora 12:32:36, në faqen nr. 1, është përshkruar se “nuk është paraqitur paditësi Spiro Lala”, ndërkohë që në vijim të seancës gjyqësore të zhvilluar rezulton se paditësi S. L., ka qenë i pranishëm.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

94. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Ritheksoj se sipas interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 1, datë 27.4.2015, procesverbali është ai që mbahet në formë të regjistrimit audio dhe jo shënimet e sekretares, që kanë thjesht funksion orientues. Kështu, kam bindjen se bëhet fjalë për gabim të sekretares, kur ka bërë shënimet përkatëse, por në regjistrimin audio kur kam verifikuar prezencën e palëve me siguri që e kam relatuar praninë e paditësit”.*

Vlerësimi i trupit gjykues

95. Trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se shpjegimet e subjektit kanë rezultuar bindëse, për sa kohë që ndonjë gabim njerëzor në shënimet e sekretarisë gjyqësore nuk mund të konsiderohet një mangësi procedurale apo profesionale e gjyqtarit. Për rrjedhojë, vlerësohet se në çështjen në analizë nuk janë konstatuar shkelje procedurale nga subjekti.

7. Denoncimi nr. * prot., datë 1.10.2019, i shtetasit J. S.**

96. Shtetasi J. S. shprehet se subjekti i rivlerësimit është duke gjykuar disa çështje me të njëjtin objekt gjykimi dhe, si pasojë, atij i shkaktohen dëme ekonomike. Me kërkesë të Komisionit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2021, vuri në dispozicion vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimi nr. ***, datë 4.3.2016, në të cilin ka vendosur “moskompetencën tokësore” të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për gjykimin e çështjes me objekt “goditje për falsitet të vendimit nr. ***, datë 24.8.1960, të Komitetit Ekzekutiv Popullor të Sarandës”, me palë paditëse denoncuesin dhe palë të paditur M. Z. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. ***, datë 22.9.2016, ka vendosur “prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe dërgimin e saj për vazhdimin e gjykimin”. Çështja është gjykuar nga i njëjti trup gjyqësor, i cili në përfundim ka vendosur, me vendimin nr. ***, datë 22.12.2017, “rrezimin e padisë”, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër me vendimin nr. ***, datë 22.5.2018.
97. Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë konstatohet se denoncuesi ka ngritur një tjetër padi me objekt “anulim i vendimit, pavlefshmëri e vendimit

³² Subjekti i rivlerësimi ka njoftuar palën nëpërmjet gjendjes civile, adresës së paraqitur dhe numrit të telefonit të disponuar nga paditësi.

dhe fshirje nga regjistri hipotekor”, dhe se kjo çështje është regjistruar në datën 10.10.2017 dhe i ka kaluar për gjykim subjektit të rivlerësimit, i cili në datën 22.12.2017, ka depozituar “kërkesën për dorëheqje”. Çështja më pas është gjykuar nga një tjetër gjyqtar ku në përfundim është vendosur “pushimi i çështjes”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

98. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Në lidhje me bazueshmërinë e vendimmarrjeve përkatëse nuk kam ndonjë koment, pasi ato janë vlerësuar nga gjykatat më të larta. Në çdo rast vlerësoj se kam interpretuar dhe zbatuar ligjin në dhënien e vendimeve, sipas formimit tim profesional dhe nuk kam kryer ndonjë shkelje procedurale ose disiplinore. Sidoqoftë, subjekti ankohet se po i shkaktohen dëme ekonomike pasi kam shqyrtuar disa çështje me të njëjtin objekt gjykimi, fakt që nuk është i vërtetë. Në çështjet e gjykuara ku ankuesi ka qenë palë nuk kishte pengesë që të shqyrtoheshin nga i njëjti gjyqtar. Në rastet që kanë qenë kushtet për heqjen dorë, e kam paraqitur kërkesën si në rastin që referohet më sipër”.*

Vlerësimi i trupit gjykues

99. Trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se shpjegimet e subjektit kanë rezultuar bindëse dhe se në çështjen në analizë nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi etiko-profesionale nga subjekti.
100. Në këto kushte, trupi gjykues, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLGJ-ja, si dhe denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Pina, ka arritur një nivel kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Pina:

- a. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Pina, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Pina, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 27.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI

Kryesuese

Lulzim HAMITAJ

Relator

Roland ILIA

Anëtar

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi